



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**Nr.50 Datë 21.03.2007**

**Për**

**Vendosje gjobe ndaj shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm, për produktin Policë Kufitare**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- |                            |            |
|----------------------------|------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar    |
| ▪ Zt. Lush Përpali         | Zv/Kryetar |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Anëtar     |
| ▪ Zt. Koço Broka           | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2007, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Kufizimi i konkurrencës, si rezultat i sjelljes së shoqërive të sigurimit, koordinimit të veprimeve të tyre, të formalizuara në akt marrëveshjen e datës 05.04.2005.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 45, neni 4, pika 1, neni 74, pika 1, shkronja a, neni 17, pika 2 dhe neni 80.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit të Grupit të Punës të datës 9.3.2007, Relacionit të Sekretares së Përgjithshme bashkëlidhur këtij raporti, pas dëgjimit të palëve objekt hetimi, dhe pasi dëgjoji në një seancë konsultative Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, si dhe administrimit të akteve shkresore

**V Ë R E N S E:**

1. Marrëveshja e datës 05.04.2005, nënshkruar nga shoqëritë e sigurimit dhe të miratuar me Vendimin Nr. 6, datë 18.5.2005 në Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarëve, është marrëveshje e ndaluar, e cila bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1, shkronja a të Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, mbasi nëpërmjet kësaj marrëveshje shoqëritë fiksojnë çmimin dhe ndajnë tregun.
2. Tregtimi/Shitja e Policës së Sigurimit Kufitar realizohet vetëm nga agjenti juridik Union Distribution Servis Albania (UDSA), në zbatim të kontratës me afat dy vjeçar, të lidhur me B.SH.S, e cila vepron si përfaqësuese e

emëruar në emër të 8 (tetë) shoqërive të sigurimit, në bazë të akt marrëveshjes së lidhur në datën 05.04.2005, nga shoqëritë e sigurimit dhe të miratuar me Vendimin Nr. 6, datë 18.5.2005 në Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarëve;

3. Ndarja e të ardhurave nga shitja e policës së sigurimit kufitar, bëhet me Urdhër të Ministrit të Financave, bazuar në pjesën e tregut për TPL-në, që zë çdo shoqëri në tregun e sigurimit të detyrueshëm. Vetëm për vitin 2005, ndarja e të ardhurave nga shitja e policës së sigurimit është bërë sipas % të përcaktuara në akt marrëveshjen e datës 05.04.2005;
4. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 28 datë 23.12.2005 është shprehur për ndërprerjen e menjëherëshme të kësaj marrëveshje, si marrëveshje e ndaluar me objekt dhe pasojë kufizimin e konkurrencës. Por ky vendim nuk është zbatuar, shkak i cili e detyroi Komisionin e konkurrencës të marrë vendimin Nr 45, datë 19.1.2007 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimeve për produktin TPL”.
5. Tarifat e primit për ofrimin e shërbimit të sigurimit të detyrueshëm, Polica Kufitare, të zbatuara nga shoqëritë apo nëpërmjet agentit, janë në të njëjtin kufi, brenda marzhit të përcaktuara në Urdhërin Nr. 12, datë 18.4.2006 të Ministrit të Financave;
6. Aktet nënligjore të Ministrit të Financave për të ndërhyrë në tregun e Policës kufitare dhe që i japin fuqi BSHS-së, janë jashtë kompetencave të përcaktuara në ligj dhe statut për funksionimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d, nenin 45, nenin 4, pika 1, nenin 74, pika 1, shkronja a, nenin 17, pika 2 dhe nenin 80 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 „Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

### **V E N D O S I:**

1. Ndalimin e akt-marrëveshjes së datës 05.04.2005 “Mbi themelimin e Pool-it të Sigurimit Kufitar të Përgjegjësive ndaj palëve të treta të mbajtësit të mjetit motorrik”, e lidhur nga 8 (tetë) shoqëri siguri, që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimeve dhe konkretisht: Sigma Sh.a, Sigal Sh.a, Atlantik Sh.a, Intersig Sh.a, Interalbani Sh.a, Albsig Sh.a, Eurosig sh.a (ish Dukagjini Sh.a), si dhe Insig Sh.a, si marrëveshje e ndaluar me pasoja kufizuese për konkurrencën, mbasi fikson çmimin dhe ndan tregun.
2. Vendosjen e gjobës në masën 2% të xhiros të vitit 2005, ndaj shoqërive pjesëmarrëse në marrëveshjen e datës 05.04.2005 dhe konkretisht:
  - Shoqërisë Sigma Sh.a,
  - Shoqërisë Sigal Sh.a,

- Shoqërisë Atlantik Sh.a,
  - Shoqërisë Intersig Sh.a,
  - Shoqërisë Inter Albania Sh.a,
  - Shoqërisë Albsig Sh.a,
  - Shoqërisë Insig Sh.a,
  - Shoqërisë Eurosig Sh.a,
3. Të njoftohet Byroja Shqiptare e Sigurimit për ndalimin e marrëveshjes datë 05.04.2005 “Mbi themelimin e Pool-it të Sigurimit Kufitar të Përgjegjësive ndaj palëve të treta të mbajtësit të mjetit motorrik”, si marrëveshje e ndaluar.
  4. Të njoftohen shoqëritë e sigurimit që tregtimi/ofrimi i shërbimit të policës kufitare të realizohet nga vetë shoqëritë në sportelet e tyre, dhe/ose nëpërmjet kontratave dypalëshe me agjentë të ndryshëm fizikë e juridikë.
  5. Të njoftohet ky vendim Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.
  6. Policia tatimore kryen ekzekutimin e gjobës të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.
  7. Ngarkohet Sekretariati për ndjekjen, zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot me datë 21.03. 2007

## **KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Lush Përpali**

**Servete Gruda**

**Koço Broka**

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

**Zv/Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Lindita Milo (Lati)**

**K R Y E T A R**